



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

ZYRA E KRYETARIT

01-352-21139/2025

11.07.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, në bashkëpunim, dhe propozim të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, merr këtë:

V E N D I M

Për

Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Caktohet Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Kpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljakë etj.,** me operator; "Mendi Invest Sh.P.K; Ideor Construction Sh.P.K., Rr 28 Nenori- Ujmirë, Klinë dhe me numër të biznesit; 811983916.

Me numër të prokurimit: 634-25-3606-5-2-1 dhe me numër të kontratës 45-2025, plani për implementimin e kontratës është 30 ditë.

Vlera e kontratës është 33.350.00 Euro

- I. ARJETA DODAJ Menaxher i kontratës (Udhëheqës i ekipit) caktohet:
Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____
SHEHORIT GASHI Menaxher i kontratës caktohet:
Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____
ELVIS PERLESI Menaxher i kontratës caktohet:
Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet:

II. **Qendrim Millaku**, Drejtor për Drejtorinë e Shërbimeve Publike .

1. **Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës** obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe emërimit të Menaxherit të kontratës (MK) të gjitha përgjegjësitë përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek Menaxheri i Kontratës.

2. **Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:**

Menaxheri i kontratës do të:

- a. menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
- b. sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë dhe
- c. bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontratës janë:

- a. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- b. Menaxheri i kontratës, duhet të lexoj kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- c. Të dorëzoj Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyre të prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerr urdhër blerjen;
- d. Pas pranimit të urdhër-blertes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkoj në platformën elektronike urdhër-blertes dhe të përcjell të njëjtën përmes platformës tek OE, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- e. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f. Të sigurojë që Operatori ekonomik të dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

- g. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- l. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- n. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi dhe
- o. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontratë siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

3. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
 - Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit - vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ .

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Prokurimit;
- Menaxherit të kontratës;
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës;
- Njesisë së Kërkesës;
- Arkivit të Komunës.

ZKA – KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

Nr 352-21139/25

DATE 11.07.2025

KONTRATË NR. 45-2025

Numri i kontratës¹: 634-25-3606-5-2-1/C881

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik MENDI INVEST SH.P.K.; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K., Rr. 28 Nentori- Ujmire, Klinë, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Kpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljakë etj. me numër identifikues: 634-25-3606-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Kpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljakë etj.

1.2 Punet do të behen në fshatin Zabergjë.

No.	Lot
1	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Kpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljakë etj.

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 33,350.00 €; tridhejt e tremijë e trqind e pesdhejt Euro.
- 2.2 Plani dinaiik eshte 30 dite
- 2.3 sigurimi i ekzekutimit do te jete 3,350.00 euro me validitet 30+30= 60 dite

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Në bazë të situacioneve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Organi Mbikqyres dhe Fature

- Mbajtja e paras në vlerë 3,350.00 € do të paguhet pas Afatit të garancionit të punimeve mbas 12 muajve pas pranimit të perkoheshem teknik . Kjo mund të paguhet me garancion nëse ekzistojn mjetet në dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

Vertetimi Tatimor

Certifikata e gjykates

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cëkin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


27

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	11/07/2025
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	YETON SHALIA
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	11/07/2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

1000

1000

1000

1000

1000

NDERTMIMI I PARKUT NE FSHATIN ZABERGJË

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

1	Punët parapërgatitore				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1.1	Përgaditja e terrenit për fillimin e punimeve. Germimi Pastrimi i terrenit dhe largimi i gjerave dhe objekteve të vjetër me themele muri betonit cilat pengojnë në parqe, mbeturinat të largohen në distancë deri 10 km	m²	2000.00	0.20 €	400.00 €
1.2	Pozicionimi i mjeteve dhe materialit të nevojshëm për fillimin e punimeve	total	1.00	50.00 €	50.00 €
1.3	Furnizimi dhe punimi i tabelave informuese për kryerjen e punimeve. Punimi i bazës së tabelës të punohet nga profilet metalike të pershtatshme në qendrueshmeri, dhe nga ilmarina metalike ku do të vendoset baneri informues me dimensione 150x150 cm.	total	1.00	70.00 €	70.00 €
1.4	Furnizimi dhe rrethimi pushishtës ku do të egzekutohen punimet. Në çmim të përfshihet vendosja dhe largimi rrethojës në memoentë e përfundimit të punimeve.	total	1.00	150.00 €	150.00 €
Pozicioni total 1:					670.00 €
2	Punët e dheut, zhavorrit dhe rërës				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
2.1	Furnizimi dhe mbushja e terrenit me dhe të pershtatshëm për mbjelljen e barit (dhe i pastër, pa barishte dhe përmbajtje tjera) me qëllim të nivelimit të terrenit. Gjendja aktuale e terrenit nuk është e rrafshët ku nga rruga kryesore terreni vazhdon të ketë rënie deri në 1 m. Andaj dheu do të përdoret për nivelimin e terrenit ku është parapare të punohet memoriali.	m³	200	2.00 €	400.00 €
2.2	Kompaktimi i dheut të hudhur parapkrakisht në sipërfaqen e terrenit sipas normave dhe standardeve konstruktive me ngjeshmeri të njëtrajtshme deri në 80 Mpa.	m²	2000	0.10 €	200.00 €
2.3	Gërmimi i gjërë i dheut të kategorisë së III me makina ndërtimore për lërgimin e dheut ku do të punohet parterit. Në këtë pozicion përfshihet gërmimi i dheut në thellësi prej 50cm në tërë hapësirën ku do të punohet membranorali si dhe shtrimi i parterit me kubeza	m³	300.00	2.00 €	600.00 €
2.4	Furnizimi dhe punimi i zhavorrit me fraksion prej 0 - 63 mm, me shtresë prej 20 cm, për të stabilizuar dheun e parapare të bëhet ngjeshja e shtresës stabilizuese deri në nivelin e nevojshëm për përgaditjen e pllakes beton arme.	m³	60.00	9.00 €	540.00 €
2.5	Furnizimi dhe punimi i zhavorrit me fraksion prej 0 - 36 mm, me shtresë prej 20 cm, për mbushjen e hapësirave brenda pllakes së themelit dhe pllakes së bazës së objektit. Në çmim të parashihet furnizimi dhe mbushja e hapësirave me zhavor.	m³	60.00	9.00 €	540.00 €
2.6	Furnizimi dhe punimi i zhavorrit i cili vendoset në fazën përfundimtare për vendosjen e kubezave, Zhavori përdoret për nivelimin e terrenit ku pastaj vendosen kubezat. Në këtë çmim përfshihet furnizimi, punimi si dhe mbushja e fushave në fazën përfundimtare (pas vendosjes së kubezave.	m³	20.00	15.00 €	300.00 €
					2,580.00 €

3	Punët e betonit dhe Rrethojës				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej

1.7.00 €
1.3.00 €
3.775.00 €
1.250.00 €

3.1	Furnizimi i materialit si dhe punimi i betonimit te themelil-pllake te memorialit me trashesi d=30 cm sipas punimit te llogaritjes statike dhe planit te armatures me beton arme te klasit C 25/30, te formesuar me kallepe te derrasave. Ne cmim te llogaritjet edhe shtresa aditive per papershkueshmeri nga uji. Betoni gjate punimit duhet te vibrohet me vibrator dhe te mirembahet sipas rregullave dhe normave te cilat jane ne fuqi. Ne cmim duhet te llogaritjet edhe armimi adeakuat i tije.	m³	1.50	150.00	225.00 €
3.2	Furnizimi i materialit si dhe punimi i betonimit te nivelit te pare dhe te dyte te memorialit me trashesi d=40 cm sipas punimit te llogaritjes statike dhe planit te armatures me beton arme te klasit C 25/30, te formesuar me kallepe te derrasave. Betoni gjate punimit duhet te vibrohet me vibrator dhe te mirembahet sipas rregullave dhe normave te cilat jane ne fuqi. Si dhe ne cmim te perfhihen te gjitha fazat e kallupimit te tije. Ne cmim duhet te llogaritjet edhe armimi adeakuat i tije.	m³	2.50	150.00	375.00 €
3.3	Furnizimi i materialit si dhe punimi i betonimit te memorialit sips skemes se paraqitur ne projekt dhe sipas punimit te llogaritjes statike dhe planit te armatures me beton arme te klasit C 25/30, te formesuar me kallepe te derrasave. Betoni gjate punimit duhet te vibrohet me vibrator dhe te mirembahet sipas rregullave dhe normave te cilat jane ne fuqi. Si dhe ne cmim te perfhihen te gjitha fazat e kallupimit te tije. Ne cmim duhet te llogaritjet edhe armimi adeakuat i tije.	m³	2.50	160.00	400.00 €
3.4	Furnizimi i materialit si dhe punimi i betonimit te themelit shpute ne pozicionet ku di te vendojn ndriqimi i larte si dhe streha sips skemes se paraqitur ne projekt dhe sipas punimit te llogaritjes statike dhe planit te armatures me beton arme te klasit C 25/30, te formesuar me kallepe te derrasave. Betoni gjate punimit duhet te vibrohet me vibrator dhe te mirembahet sipas rregullave dhe normave te cilat jane ne fuqi. Si dhe ne cmim te perfhihen te gjitha fazat e kallupimit te tije. Ne cmim duhet te llogaritjet edhe armimi adeakuat i tije.	m³	1.50	150.00	225.00 €
3.5	Furnizimi dhe Betonimi murit mbrojtës ne perimeter te parceles. Jan te ndara ne themel dhe muri. Detajet dhe dimensionet jan te paraqitura ne projekt. Klasa e betonit C30/37 ; Në çmime njësi duhet të llogariten te gjitha punët në lidhje me përgaditjen e kallëpeve, montimin dhe përfundimin e tyre si dhe skelet e nevojshme për kryerjen e operimeve të cilat ndërlihen jo vetëm me punët e kallëpimit po edhe të betonimit të elementeve strukturore relative dhe punët tjera të ngjajshme. Marka e betonit caktohet sipas rezultateve te llogaritjes statike. Te gjitha testet dhe shqyrtimet e nevojshme te perfshihen ne cmim.	m³	15.00	120.00	1,800.00 €
3.6	Furnizimi me hekur ndërtimor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armaturës të hekurit të brinjëzuar të klasës S 400 500 , të gjitha në përputhje me llogaritjen statike te armimit. Llogaritja në kg.	kg	1000.00	0.80	800.00 €
3.7	Furnizimi, transporti dhe Montimi i rrjetes panel 2D me profile Ø4 mm me dimensione 1.2 x 2.0 m , rrjeta duhet të jetë e gjelbert e plastifikuar .Në qmim hyn montimi me elemente i rrjetes komplet në qdo profil shtylle vertikal edhe horizontal shtyllat janë qdo 2.5 m . Ne qmin hyn edhe furnizimi edhe montimi i kapseve për forcimin e rrjetes .Ne qmim hyn gjitha elementet tjera Llogaria në ml.	m'	70.00	15.00	1,050.00 €

3.8	Furnizimi dhe montimi i shtyllave per rrethoje me dimensione 50x50x2 mm qdo 2.5 m distanc ne murin e betonit , te parashihet edhe pllaka dhe 4 ankera .	copë	28.00	10.00	280.00 €
3.9	Furnizimi dhe montimi i dverve te hyrjes nga metali. Dimensionet dhe dizajni jan te paraqitura ne Projekt. Dera per vizitore ka gjeresi 1.5m dhe lartesi 1.40 m. Metali fillimisht te ngjyroset per mbrojtjen nga korrozioni apo ndryshku dhe pastaj me ngjyre kualitative qe zgjidhet bashk me organin mbikqyres. Llogaria në cope	copë	1.00	120.00	120.00 €

Total Position 3: 5,275.00

4	Punët e Granit dhe te gurit dhe bustit				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
4.1	Furnizimi i materialit si dhe punimi i Granitit natyral ne pozicionet e parapara ne projekt. Granit me trashesi prej 2.0 cm . Me detajisht te identifikohet dhe te percillet sipas projektit. Ne projekt te parashihet furnizimi i materialit, transporti dhe punimi i tij. Verejtje: graniti duhet me vendoset ne nje pllake pa nderprerje ne tere hapsiren ku do te vendoset. Ngjyra granitit do caktohet nga organi mbikqyres . Baza duhet të jete e ngjashme si në foto pasi do të vendoset një bust	m²	10.00	110.00 €	1,100.00 €
4.2	Furnizimi i materialit si dhe punimi i dy vazove te mermerit natyral ne pozicionet e parapara ne projekt. .Me detajisht te identifikohet dhe te percillet sipas projektit. Ne projekt te parashihet furnizimi i materialit, transporti dhe punimi i tij.	cope	2.00	60.00 €	120.00 €
Total Position 5:					1,220.00 €

6 Rregullimi i Oborrit dhe Punet tjera					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
6.1	Furnizimi, transportimi dhe vendosja e kubezave të betonit me dimensione 30x20 cm dhe trashësi t=6 cm në hapësirën e shtigjeve, trotuarit si dhe pjesës qendrore të parkut. Renditja e pllakave të bëhet sipas dizajnit të punuar në projekt. Ngjyrat dhe lloji i kubezave do të caktohen nga organi mbikqyres.	m ²	500.00	17.00 €	8,500.00 €
6.2	Furnizimi, transportimi dhe punimi i ansoreve përgjatë shtigjeve të objektit trotuarit edhe kufizimeve tjera në cmim të përfshiet furnizimi dhe punimi i tyre paraprakisht me baze betoni.				
	me dim.18x24x100cm	m'	200.00	10.00 €	2,000.00 €
	me dim.10x20x100cm	m'	500.00	8.50 €	4,250.00 €
6.3	Furnizimi transporti dhe mbjellja e barit në terë sipërfaqen e gjelbruar të parces. Në këtë llogari të meret edhe rrafshimi i terrenit si dhe ngjeshja e dheut me makineri perkatese.	m ²	1000.00	1.00 €	1,000.00 €
6.4	Furnizimi dhe mbjellja e gjelberimit të lartë me emer (<i>Platanus Hispanica</i>). Në cmim të përfshiet furnizimi mbjellja e tyre neper pozocionet e parashikuara si dhe në koordinim me menagjerin e kontrates.	cope	30.00	55.00 €	1,650.00 €
6.5	Furnizimi dhe mbjellja e gjelberimit të ulët me emer (<i>Prunus Laurocerasus</i>) propozimim të projekt. Në cmim të përfshiet furnizimi mbjellja e tyre neper pozocionet e parashikuara si dhe në koordinim me menagjerin e kontrates.	cope	30.00	25.00 €	750.00 €
6.6	Furnizimi dhe vendosja në teren e ulësve sipas propozimit të projekt. Modeli i ulësve do të caktohet nga organi mbikqyres	cope	4.00	190.00 €	760.00 €
6.7	Furnizimi dhe vendosja në teren e shportave për hüdhe të mbeturinave sipas propozimit të projekt .Modeli i shportave do të caktohet nga organi mbikqyres	cope	4.00	150.00 €	600.00 €
6.8	Shkronjat të jenë Punimi i emrave dhe datave duhet të jenë të gdhendura në Granit sipas projektit. Në cmim të përfshiet punimi dhe vendosja e tyre sikur në projekt. Llogaritja për shkronje	cope	30.00	4.00 €	120.00 €
6.9	Furnizimi dhe montimi i dy shtyllave metalike me H=6 të me elementet përcjellse për vendosjen e 2 flamunjeve	cope	2.00	100.00 €	200.00 €
Pozicioni Total 6:					19,830.00 €
7 Punët Elektrikes - Hapsira 2000 m2					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
7.1	Instalimi i të gjitha pjesëve dhe kabllëve të nevojshme për furnizim me energji elektrike për terë hapësirat e parapara për furnizim dhe ndriqim të ambientit. Në projekt të parashihet furnizimi dhe punimi - instalimi deri në finalizim me energji elektrike.	total	1.00	450.00 €	450.00 €
7.2	Furnizimi i ambientit me trupa ndriqes (shtylla me ndriqim h=5m dhe dritë LED) . Shtyllat të parashihen të ngjashme si ato të parapara në projekt. Në qmim të përfshiet edhe finalizimi i tyre me relaim deri në finalizim në terren. Modeli i dritave do të caktohet nga organi mbikqyres	total	20.00	120.00 €	2,400.00 €
7.3	Furnizimi i ambientit me trupa ndriqes të lartë me gjatësi 50 cm . Parashihen të ngjashme si ato të parapara në projekt. Në qmim të përfshiet edhe finalizimi i tyre me relaim deri në finalizim në terren. Modeli i dritave do të caktohet nga organi mbikqyres	total	15.00	45.00 €	675.00 €

9,530.00 €


Gjithsej

7.4	Furnizimi si dhe punimi i te gjitha fazave te tjera per vendosjen e kaseter furnizuese. Ne cmim te perfshihet edhe instalimi apo lidhja e energjise elektrike ne furnizimin me te afert. Ne kasete te parashihen te gjitha fazat e nevojshme (lidhje, furnizim, nderpresa, siguresa, nje prize per furnizim, sensorit automatik dite-nate etj).	total	1.00	250.00 €	250.00 €
-----	--	-------	------	----------	----------

Total Position 7: 3,775.00 €

REKAPITULLIMI I PUNIMEVE ZEJTARE NDËRTIMORE

1	PUNËT PËRGATITORE	670.00 €
2	PUNËT E DHEUT	2,580.00 €
3	PUNËT E BETONIT	5,275.00 €
4	PUNËT E MERMERIT	1,220.00 €
5	PUNËT E RREGULLIMIT TË JASHTËM	19,830.00 €
6	PUNËT E ELEKTRIKES	3,775.00 €
TOTAL:		33,350.00 €



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-25-3606-5-2-1/C881

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11

Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuëse të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12

Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13

Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14

Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

